

# Reksioni dhe valenca foljore

Mr. Agim Spahiu

qershor 2002

## Përmbledhje

Nga vetë titulli mund të shihet së autori në këtë shkrim është marrë një një çështje problemore terminologjike. Pse thuhet çështje problemore? Sepse autori ka trajtuar dy nocione gjuhësore që për shumikë, madje edhe për njerëz me përgatitje profesionale, janë të njëjta, identike ose të ngjashme. Prandaj autori ka sjellë këtu disa të dhëna teorike, referenca të shumta nga literatura gjuhësore e gjuhëve të tjera (sepse në gjuhën shqipe përgjithësisht mungojnë ato, ose janë fare të pakta) për të dëshmuar dhe për të sjellë përfundimin se këta dy terma, me disa pikëpërkime të vogla, janë të ndryshëm dhe s'ka arsye të ngatërrohen apo të identifikohen në mes vete, ngase kemi të bëjmë me dy fusha (rryma) të ndryshme gjuhësore-teorike, që marrin për bazë njërin apo tjetrin. Prandaj, meriton edhe të lexohet dhe të shihen ato pikëdallime në mes tyre.

## 1 Një vështrim i përgjithshëm

**Reksioni dhe valenca** janë dy terma që përdoren në fusha të ndryshme të gjuhësisë së përgjithshme, në mënyrë të veçantë në gramatikat rasore, dependenciale e valencore.

Në gjuhësinë shqiptare përdoren shumë rrallë. Përmenden aty - këtu në ndonjë studim, trajtesë, artikull etj. nga studiuesit tanë, por nuk i gjejmë të jenë përdorur në gramatikat universitare. Madje, në disa raste, kemi vënë re se, edhe kur përdoren, ngatërrohen në mes vete, d. m. th. identifikohen terminologjikisht dhe kuptimisht në mes vete, thuajse janë dy emërtime sinonimike për të njëjtën gjë. Dhe këtu qëndron thelbi i problemit, të cilin do ta shtrojmë në këtë kumtesë.

Në anën tjetër, studimet e bëra në gjuhë të tjera e kanë shpjeguar këtë çështje qysh moti dhe kanë sjellë përfundimin se këta terma, si për nga forma, ashtu edhe për nga përmbajtja, me gjithë disa pikëpërkime, janë të dallueshëm.

## 2 Si dhe sa janë trajtuar këto nocione në gjuhësinë tonë?

Në gjuhësinë shqiptare termi reksion është përdorur dhe përkufizuar qysh më 1966 nga S. Riza në studimin *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Sipas tij, reksion (lat. rectionem = qeverisje, sundim, drejtim) i një foljeje veprimi quhet raporti i vetë

foljes si skaj drejtues ndaj kundranës së saj si skaj i drejtuar<sup>1</sup>. Po në këtë kohë (më 1965) edhe A. Dhrimo e kishte bërë një studim për këtë segment të rëndësishëm gramatikor. Studimi i tij mban titullin *Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme letrare*<sup>2</sup>. Aty janë marrë në shqyrtim grupe të caktuara foljesh të cilat **sundojnë a qeverisin**, në mënyrë të fortë a të dobët mbi trajta emërore, ndajfoljore<sup>3</sup> etj. Më vonë, nuk jemi në dijeni në është bërë apo jo ndonjë studim për to në trevat tona nga studiuesit tanë.

Termi **reksion** nuk përfshihet në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980)*, ndërsa termi **valencë** përmendet vetëm si term kimie. Shkak i mospërfshirjes së këtij termi, por edhe shumë termave të tjerë gjuhësorë ndër fjalorë e gramatika të shqipes, mund të jetë edhe fakti se gjuhësia shqiptare, sikundër dihet, ka ndjekur rrugë krejt tjera hulumtuese, me metoda e parime të tjera metodologjike për një kohë bukur të gjatë, për dallim nga ato të vendeve të zhvilluara evropiane.

### 3 Si janë shpjeguar ndër fjalorë të gjuhësisë dhe trajtuar në gramatika e studime të ndryshme të gjuhëve të huaja?

Në fjalorin e njohur qëmoti të R. Simeonit *Enciklopedijski rjecnik lingvističkih naziva (vëll. I, II, Zagreb, 1969)* termi reksion është shpjeguar mjaft gjerë. Këtu po i paraqesim vetëm disa nga pikat më kryesore. Këtë term e gjejmë të përkufizuar në disa mënyra, si: Varësia sintaksore e një fjale mbi tjetrën, ose një fjalë kërkon plotës në rasë të caktuar; përcaktimi i raporteve të varësisë së një fjale mbi tjetrën me anë fleksionit; mundësia e një fjale të përcaktojë rasën e atyre fjalëve në fjali e cila në të është e varur; aftësia e fjalëve që t' i bashkohet plotësit ose lidhja e nevojshme që të lidhen dy fjalë mes vete, por me kusht që njëra të varet gramatikisht nga tjetra; fjala drejtuese morfologjikisht përcakton fjalën e drejtuar, p. sh folja e gjuhës frënge *suivre* e drejton një plotës me parafjalë (a, dans); folja e gjuhës gjermane *helfen* e drejton dhanoren; parafjala e gjuhës latine *in* e drejton kallëzoren ose rrjedhore<sup>4</sup>. Në këtë Fjalor flitet për disa lloje reksionesh, si: për reksionin e fortë dhe të dobët, të dyfishtë, rasor, parafjalor, foljor, absubstantiv, të statusit etj. Për reksionin e fortë thuhet se karakterizohet nga zgjedhja e kufizuar dhe rigoroze e parafjalëve dhe e trajtave rasore të fjalëve drejtuese; p. sh.: rus: dorozhit cem; izbegat cevo; nadejatsja na shto etj. Ndërsa për reksionin e dobët thuhet: drejtimi i dobët, drejtimi sintaksor, madje edhe reksion i lirë ose sintaksor: reksioni me të cilin shënohet lidhja e lirë e fjalës drejtuese (kryesore) me trajta të ndryshme të fjalëve të drejtuar: reksioni i dobët pa parafjalë, reksioni i dobët me parafjalë; rus: idti k komu, ot kavo etj. Ndërsa për reksionin e dyfishtë thuhet se varshmëria e dy trajtave rasore të fjalëve reciproke nga veçoritë leksiko - gramatikore të fjalëve drejtuese, p. sh.: rus. zapreshcat

<sup>1</sup>ASHAK, Selman Riza, *Vepra 2*, Prishtinë, 1997, f. 95 -101 .

<sup>2</sup>Ky artikull është botuar në SF, 2/ 1965 dhe në vëllimin *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1972, f. 237 .

<sup>3</sup>Shih artikullin e përmendur, f.237 e tutje.

<sup>4</sup>Fjalor i cituar, 276- 277.

kamo shto (dat. + akuz.); zhdëljat kamu cevo (dat. + gen.)<sup>5</sup>. Në këtë Fjalor R. Simeoni nuk lë pa e përmendur edhe reksionin te njësitë sintaksore, kur një fjali e nënrenditur drejtohet nga një tjetër kryesore a drejtuese ( Po aty, f. 277.). Edhe J. Dubois - i e J. Jernej- i e kanë konceptuar dhe zbërthyer këtë element gramatikor në një mënyrë pak a shumë të ngjashme si Simeoni. J. Dubois -i në *Dictionnaire de linguistique* (Paris, 1973) reksionin e ka konsideruar si aftësi që një folje të bashkohet (të shoqërohet) me një plotës të caktuar. P. sh. reksioni i drejtë merr një kundrinë të drejtë pa parafjalë kur folja është kalimtare (ose në akuzativ); ose, në anë tjetër, është i zhdrejtë kur kundrina ka një parafjalë (në dativ, genitiv, ablativ etj). Reksioni është i drejtë në shembullin: Pjetri lexon gazetën; ndërsa i zhdrejtë: Pjetri qortohet prej prindërve<sup>6</sup>. Ndërsa J. Jernej -i në Gramatikën italiane të tij si *aftësi të një fjale që sintaksorisht të drejtojë fjalën tjetër dhe, nëse fjala drejtuese varet nga folja, mund të shprehet kundrina e drejtë, e zhdrejtë*<sup>7</sup>. Në një mënyrë pak a shumë të ngjashme përkufizohet ky term edhe nga ana e O. Ducrot-it dhe J. - M. Schaffer -it . Në Fjalorin e tyre *Nouveau dictionnaire encyclopedique des sciences du langage* ( botim i vitit 1995) këtë term e gjejmë të përkufizuar në këtë mënyrë: Un mot **regit** un autre lorsqu' il lui impose une certaine forme: ainsi beaucoup de verbes latins ou allemands imposent le cas accusatif leur coplement d' object<sup>8</sup>, pastaj autorja gjermane Ch.Dürcheid termin reksion e ka përkufizuar në këtë mënyrë: *Reksion bezeichnet den Umstand, dass die Form einer Konstituenten duech eine andere festgelegt wird, në tekstin e saj Syntax, Grundlaen und Theorien*<sup>9</sup> etj.

Në anën tjetër, termi **valencë**, si duket, është shumë më i vonshëm dhe, si i këtillë, nuk e gjejmë në mjaft fjalorë të gjuhësisë dhe në gramatika. Në Fjalorin e sipërpërmendur të Simeonit e gjejmë vetëm këtë shënim: Valencë; në gjuhësi: vlerë, vlerëshmëria e ndonjë mjeti gjuhësor nga aspekti i funksionit dhe i kuptimit<sup>10</sup>, kurse në atë të J. Dubois-së nuk e gjejmë fare këtë term.

Në studimet e mëvonshme gjendja ndryshon në mënyrë progresive. Kështu, fjala vjen, **D. Kristal-** i në *Fjalorin enciklopedik të gjuhësisë moderne* e shpjegon këtë term mjaft gjerësisht, duke sjellë të dhëna të mjaftueshme për të. Aty thuhet fillimisht se këtë term e solli gjuhëtari frëng L. Teniere (L. Tesniere 1893 - 1954), i cili ka pasur ndikim të veçantë në zhvillimin e modeleve të ndryshme të gramatikës dependenciale në Evropë dhe në Bashkimin Sovjetik. Është marrë nga kimia. Ky term në gjuhësi shënon numrin dhe llojin lidhjes, elementet sintaksore të të cilave mund t' i krijojnë në mes vete. Sikur në kimi, thuhet më tutje aty, elementet e dhëna mund të kenë *valenca* të ndryshme në kontekste të caktuara. Gramatika e valencës paraqet modelin e fjalive të cilin e përmban një element bazë (zakonisht folja) dhe një numër i caktuar i elementeve të varura (të quajtura me emra të ndryshëm, si: argumente, shprehje, plotësor ose valente), numri dhe lloji i të cilave varet nga valenca e foljeve. Kështu p. sh. valenca e foljes - zhdukem përfshin vetëm elementin e subjektit (ajo, pra, e ka valencën 1, është folje njëvalente),

<sup>5</sup>Fjalor i cit, f. 279.

<sup>6</sup>Fjalor i cituar, f . 407 .

<sup>7</sup>Shih J.Jernej, Talijanska gramatika , Zagreb, 1989, f. 85 .

<sup>8</sup>Shih fq. 450.

<sup>9</sup>Shih vep. e cit., Wiesbaden, 2000, f.109 .

<sup>10</sup>R . Simeon, Fjalor i cit., f. 700.

ndërsa folja - vështroj nënkupton edhe subjektin, edhe kundrinën e drejtë (e ka valencën 2, është folje dyvalente). Për foljet që nuk marrin kurrfarë plotësisht (p. sh. folja - agon) themi se kanë valencë zero, përkatësisht janë avalente. Valenca do të tregojë jo vetëm numrin e valentëve me të cilët një folje kombinohet që të formojë nukleus të fjalisë së formuar mirë, por edhe lloje të valentëve të cilët mund të kombinohen me folje të caktuara. Kështu foljet - jap dhe - vë e kanë valencën 3 (janë folje trivalente), por valentët që i kërkon folja e parë (mund të marrë kryefjalën, kundrinën e drejtë dhe të zhdrejtën), nuk janë të njëjta edhe te folja e dytë (e dyta mund të marrë kryefjalën, kundrinën e drejtë dhe rrethatorin e vendit). Por valentët të cilët dallohen në këtë mënyrë, në mes vete, mund të thuhet se i takojnë togjeve të ndryshme valentore<sup>11</sup>, - përfundon D. Kristal në Fjalorin e tij lidhur me këtë term.

Edhe këto pak referenca të prezantuara këtu janë të mjaftueshme për ardhur te përfundimi se termat **reksion** dhe **valencë** nuk duhet të njëjtësohen njëri me tjetrin, por por duhet të dallohen, si në rrafshin formal, edhe në atë përmbajtësor.

## 4 Ku qëndrojnë dallimet thelbësore në mes tyre?

Ndonëse këta terma kanë të bëjnë me të njëjtën materie gjuhësore (veçoria e përbashkët e tyre është fakti se që të dy këta terma kanë të bëjnë zakonisht me relacionin fjalë kryesore - fjalë e varur në njësi sintaksore kumtuase), në thelb duhet të dallohen e të veçohen kryesisht nga dy aspektet e sipërshënuara:

Nga aspekti formal, fjala reksion etimologjikisht rrjedh nga fjala latine *regere* (gjer. *leiten*, *regieren*, *beherrschen*; engl. *government*; fr. *rection*)<sup>12</sup>, që do të thotë *drejtim*, *qeverisje*, *sundim* etj., në një kuptim të përgjithshëm. Kurse fjala valencë, po ashtu nga lat. *valere* (gjer. *wert sein*)<sup>13</sup>, me kuptimin vlerë. Por ajo që është më me rëndësi në përqasjen e këtyre dy termave gramatikorë është aspekti përmbajtësor i tyre, i cila, siç u pa edhe nga referencat e sjella më lart, del si rezultat i pikënisjeve dhe i qasjeve të ndryshme metodologjike të fushave të gjuhësisë së përgjithshme.

Teoria mbi reksionin është një metodë më e hershme e zbërthimit të gjymtyrëve sintaksore në gramatikën tradicionale, kurse teoria mbi valencën është paksa më e vonshme (më 1959), e mbështetur në parimet themelore të së parës (ka studiues të gjuhësisë që valencën e marrin si një lloj reksioni specifik). Valenca mbështetet në metodën verbocentrike. Kjo do të thotë së folja, sipas studiuesit francez Teniere (Tesniere), është gjymtyra kryesore e cila i sundon, i mbizotëron të gjitha gjymtyrët e tjera të dyta, madje dhe vetë kryefjalën. Se sa lidhje mund të marrin foljet me gjymtyrët e përmendura si aktante (si aktant i parë emëror merret kryefjala, kallëzorja si aktant i dytë, dhanorja dhe gjinorja si aktantë të tretë; si *circonstants*, kuptohet, rrethatorët dhe si *indices* merren nyjat, përemrat mbiemërorë)<sup>14</sup>, ato, siç pamë edhe më lart, mund të jenë njëvalente, dyvalente, trivalente, madje edhe katërvalente etj. Kurse te teoria mbi reksionin kjo qasje nuk bëhet.

<sup>11</sup>Shih D. Kristal, *Enciklopedijski rečnik moderne lingvistike*, Beograd, 1988, f. 272 .

<sup>12</sup>H.Glück, *Metzer Lexikon Sprache*, Stuttgart, 2000, f. 573.

<sup>13</sup>H.Glück, *Fjalor i cit.*, f. 767.

<sup>14</sup>Shih H.Pelz, *Linguistik, Eine Einführung*, , bot . 4, 1999, f. 158- 163.

Te reksioni mund të hetohet vetëm shkalla a intensiteti i lidhjes (e fortë, e dobët etj.) që mbizotëron në mes gjymtyrës së varur dhe foljes. Madje, sipas kësaj teorie, kryefjala asnjëherë nuk është gjymtyrë e varur nga folja, siç ndodh me teorinë e valencës, por vetëm gjymtyrët e dyta, në përgjithësi. Kurse në teorinë mbi valencën (sikurse në kimi) është i rëndësishëm vetëm evidentimi i të gjitha lidhjeve të mundshme valentore mbi plotësit a aktantët e vet që mund të jenë në përgjithësi obligativë dhe fakultativë<sup>15</sup>.

Një dallim tjetër që mund të vihet re në mes tyre është edhe ky fakt: Reksioni mund të ekzistojë edhe në mes pjesëve të tjera të ligjëratës. Vetë Simeon- i në *Fjalorin e tij enciklopedik të emërtimeve gjuhësore* e ka marrë për bazë edhe këtë komponentë. Ai, në mes tjerash, aty ka pohuar se, duke e marrë parasysh se cilat fjalë i takojnë fjalës kryesore a drejtuese, reksioni mund të jetë: 1. pranëfoljor, 2. pranemëror, 3. pranëmbiemëror dhe 4. pranëndajfoljor<sup>16</sup>. Te tjerët flasin edhe për reksionin parafjalor, si p. sh. **Sh. Demiraj** në Gramatikën historike të shqipës<sup>17</sup>. Kurse, sa i përket valencës, kjo mirëfilli konsiderohet vetëm teori gjuhësore që lidhet vetëm me foljen, prandaj edhe quhet, siç u tha edhe më lart, teori verbocentrike. Por më vonë, sidomos në këto vitet e fundit, për analogji me të, janë zgjeruar studimet edhe mbi pjesët e tjera të ligjëratës të cilat, në një mënyrë a tjetër i nënshtrohen këtyre parimeve gjuhësore. Prandaj sot, fjala vjen, në studimet gjuhësore të gjuhëve të tjera shohim të flitet edhe për valencën emërore, mbiemërore, parafjalore<sup>18</sup> etj.

## 5 Përfundim

Referencat e parashtruara këtu janë të mjaftueshme për të ardhur në përfundimin se në mes termave reksion foljor dhe valencë foljore, me gjithë disa pikëpërkime, ekzistojnë disa dallime qoftë në aspektin nocionor, qoftë në atë përmbajtësor - teorik. Prandaj, nuk ka arsye dhe nuk bën t'i barazojmë a njëjtësojmë në asnjë mënyrë në mes vete, sepse është fjala për dy qasje të ndryshme metodologjike, për dy teori të niveleve të ndryshme gjuhësore.

Ndërkaq, sa i përket çështjes terminologjike, ne mendojmë se këta dy terma është mirë të futen në përdorim si të këfillë edhe ndër fjalorët e ardhshëm të gjuhësisë e të gramatikave tona, sepse tashmë kanë zënë rrënjë e po përdoren që sa kohë në numrin më të madh të gjuhëve me tradita të mëdha studimore. Por, gjëja më e rëndësishme dhe kryesore është: të bëhet ndonjë studim i plotë mbi to nga të gjitha aspektet në gjuhësinë tonë, duke e vënë në spikamë jo vetëm këtë pjesë të ligjëratës, por edhe të tjerat, te të cilat mund të hetohen a dëshmohen këto lidhje rektive e valencore etj.

---

<sup>15</sup>Po aty, f. 161.

<sup>16</sup>R.Simeon, Fjalor i cit., f.277.

<sup>17</sup>Shih Sh.Demiraj, f. 644 §40 dhe 637-638.

<sup>18</sup>Shih për këtë tekstin L. Götze Ernest W.B.Hess- Lüttich, Bertelsmann *Lexikon Verlag*, München 1999, për valencën e mërore (*Die Valenz des Substantivs*), f. 182; për atë mbiemërore (*Die Valenz des Adjektivs*), f. 227; Grammatik, Duden 4, 1996, fq. 106, 267, 392; K.E.Sommerfeld, Schreiber *Wörterbuch zur Valenz und Distribution der Substantive* (1980); *Wörterbuch zur Valenz und Distribution deutscher Adjektive* (1977).